



Islami është ndërtuar mbi pesë

Nga Ebu Abdurrahman Abdullah ibn Omer ibnul Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet të ketë thënë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: "Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla): të dëshmuarit se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, haxhillëkun dhe agjërimin e Ramazanit."

[Ky hadith është sahih.] [Muttefek alejhi.]

Abdullah ibn Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla)", respektivisht shembulli i Islamit është si i një ndërtese dhe këto pesë janë si themelet e shtyllat e ndërtesës mbi të cilat është ngritur. E para është: të dëshmuarit se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut." Pra, vetëm Allahu është Ai që adhurohet meritueshëm. Kjo është fjala e teuhidit (monoteizmit) dhe Islami nuk është i saktë pa të, si dhe medoemos duhet shqiptuar, duhet ditur kuptimi i saj dhe duhet vepruar sipas kërkesave të saj; "dhe të dëshmuarit se Muhamedi është i Dërguari i Tij". Kjo nënkupton besimin në të në çdo gjë që ka paralajmëruar, zinxhiri i transmetimit (senedi) i të cilit është i saktë për ne; respektimi i asaj që ai ka urdhëruar; shmangia nga ajo që ai ka ndaluar dhe adhurimi i Allahut të Lartmadhëruar sipas asaj që ai ka ligjësuar. E dyta: falja e namazit, që është shtylla më e rëndësishme pas dy dëshmimeve, që kryhet pesë herë gjatë ditës dhe natës. Mu për këtë, ajo është lidhje e ngushtë ndërmjet robit dhe Zotit të tij. Falja e namazit nënkupton kryerjen e saj në mënyrë të përkryer. E treta: dhënia e zekatit. Zekati është adhurim financiar që vjen një herë në vit, kur të përmbushet koha ose kur dalin e të pihen frutat. Dobia e zekatit kalon edhe te të tjerët, prandaj ka ardhur para haxhillëkut dhe agjërimin e pas namazit. E katërta: haxhillëku në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, që është një adhurim fizik, sepse njeriu e kryen atë vetë. Lejohet të kryhet për ndokënd që është nga personat që është e lejuar të kryhet për ta. Haxhillëku gjithashtu është adhurim financiar, sepse ka nevojë për pasuri e furnizim për ta kryer. E pesta: agjërimi i Ramazanit. Agjërimi është adhurim fizik, dobia e të cilit nuk kalon (te të tjerët), por nënkupton lënien e gjërave të veçanta me nijet (qëllim), që janë prishëset e agjërimin. Agjërimi është obligim gjatë vitit për një muaj, që është muaji Ramazan. Pa shtyllën e parë Islami nuk vlen. E dyta është namazi dhe, gjithashtu, pa të nuk vlen. Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "E kam dëgjuar Profetin ﷺ duke thënë: "Ajo që qëndron mes njeriut, shirkut (idhujtarisë) dhe kufrit (mosbesimit) është lënia e namazit." (E shënon Muslimi) Kuptimi i këtij hadithi është sipas domethënies së tij të jashtme dhe asgjë nuk është vërtetuar në këtë çështje që të mund ta kundërshtojë, por janë paraqitur konkluzione në kundërshtim me kuptimin e paraardhësve (të mirë, selefët). Është vërtetuar konsensusi (ixhmai) i sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) për mosbesimin e atij që nuk falet. Abdullah ibn Shekiku (Allahu e pastë mëshiruar!) ka

thënë: "Shokët e Muhamedit ﷺ lënien e asnjë veprë nuk e konsideronin kufër, përveçse lënien e namazit." (E shënon Tirmidhiu në "El Xhami" dhe Merveziu në "Tadhim kadris-salah"). Ndërkaq, sa u përket tri shtyllave të mbetura, kushdo që i lë ato pa arsye, Islami i tij është i paplotë, i tilli është i humbur shumë larg dhe është në rrezik të madh, por i tilli nuk bën kufër (nuk del nga feja), e kjo duke iu referuar teksteve të tjera.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65000>

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY

